



REPUBLIKA E SHQIPERISE KESHILLI I BASHKISE LEZHE

Bashkia, Lagja "Skënderbeu", Rruga Frang Bardhi, Lezhë – ALBANIA tel/fax: 00 355 215 2270/2268 email : keshilli@lezha.org

VENDIM

Nr 50 datë 15.11.2007

PËR RISHQYRTIM DHE NDRYSHIM TË VKB NR 43 DATË 05.10.2007

Bazuar në ligjin nr 8652 datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" dhe në zbatim të nenit 11 të ligjit nr 9780 datë 16.07.2007 "Për inspektoriatin e ndërtimit", Këshilli i Bashkisë Lezhë, mori në shqyrtim shkresën e Institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë nr 1314/1 datë 17.10.2007 "Për rishqyrtim të pikës 2/c të VKB nr 43 datë 05.10.2007", ku pas diskutimit të antarëve ;

VENDOSI

1. Rishqyrtimin e pikës 2/c të vendimit nr 43 datë 05.10.2007 "Për ngritjen e inspektoriatit të ndërtimit", dhe të bëhet ndryshimi si më poshtë vijon :
Pika 2/c Nga inspektor me profesion Jurist, të behët Me profesion Inxhinier ndërtimi / teknik i mesëm ndërtimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Lezhë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes dhe konfirmimit nga Institucioni i Prefektit të qarkut Lezhë.

**KRYETARE
ROZA HILA**